


Tregtia e jashtme e mallrave

Qershor 2022

Tiranë, më 18 Korrik 2022: Në Qershor 2022 eksportet e mallrave arritën vlerën 46 mld lekë, duke u rritur me 32,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 2,5 %, në krahasim me Maj 2022. Importet e mallrave arritën vlerën 81 mld lekë, duke u rritur me 20,8 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 1,9 %, në krahasim me Maj 2022. Deficiti tregtar i këtij muaji është 35 mld lekë, duke u rritur me 8,6 %, krahasuar me Qershor 2021 dhe me 1,0 %, në krahasim me Maj 2022.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë gjashtëmuor eksportet e mallrave arritën vlerën 253 mld lekë, duke u rritur me 43,3 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 446 mld lekë, duke u rritur me 25,9 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 193 mld lekë, duke u rritur me 8,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Qershor 2022, në rritjen e eksporteve prej 32,2 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +11,0 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +6,9 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me 4,2 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Qershor 2022




Eksportet, gjatë këtij gjashtëmujori janë rritur me 43,3 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +13,7 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +12,2 pikë përqindje, dhe “Tekstile dhe këpucë” me 6,9 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Qershor 2022, në rritjen e importeve prej 20,8 %, krahasuar me Qershor 2021, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +10,8 pikë përqindje, “ Ushqime, pije, duhan” me +3,3 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,5 pikë përqindje .

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Qershor 2022



Si gjashtëmujorë, importet janë rritur me 25,9 %, krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2021. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +10,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,8 pikë përqindje dhe “ Ushqime, pije, duhan” me +3,9 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Qershor 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Qershor 2021 janë: Itali (31,9 %), Greqi (76,5 %) dhe Spanjë (54,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Kosova (1,6 %) dhe Maqedonia (1,2 %) .

Gjatë këtij gjashtëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (53,7 %), Kosova (12,1 %) dhe Gjermania (94,5 %) . Ndërsa vendi me të cilin eksportet kanë pasur uljen më të madhe, është: Spanja (51,6 %) .

Në muajin Qershor 2022, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Qershor 2021 janë: Italia (12,6 %), Kina (5,9 %) dhe Greqia (15,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Turqia (3,8 %) dhe Gjermania (9,8 %).

Gjatë këtij gjashtëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (13,9 %), Turqia (40,6 %) dhe Kina (7,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: SHBA (3,0 %), Rusia (19,3 %), dhe Zvicra (19,0 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Qershor 2022



Shkëmbimet tregtare, gjatë muajit qershor, me vendet e BE-së zënë 59,8 %, të gjithë tregtisë. Në Qershor 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (28,6 %), Greqia (7,5 %), Turqia (7,2 %) dhe Gjermania (5,6 %).

Shkëmbimet tregtare, për gjashtëmuajorin 2022, me vendet e BE-së zënë 60,2 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Qershor 2022, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 73,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,4 %), Turqia (8,4 %), Greqia (6,8 %) dhe Gjermania (6,6 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Qershor 2022

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2021		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	Janar - Qershor 19	152	-3,6	318	2,6	-165	48,0
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	Janar - Qershor 20	125	-17,7	271	-14,6	-146	46,2
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	06 - 21	35	50,8	67	28,9	-32	51,9
	Janar - Qershor 21	177	40,9	354	30,5	-178	49,9
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	Janar - Qershor 22	253	43,3	446	25,9	-193	56,7

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Qershor 2022

	Eksporte				Importe			
	Qershor 2021	Qershor 2022	Jan. - Qershor 2021	Jan. - Qershor 2022	Qershor 2021	Qershor 2022	Jan. - Qershor 2021	Jan. - Qershor 2022
Vendet e BE-së	24.328	34.610	127.542	185.500	36.300	41.510	196.355	235.484
Austri	233	440	1.135	2.087	629	602	3.158	3.305
Gjermani	1.819	2.672	9.510	18.498	4.962	4.474	25.636	27.667
Greqi	2.354	4.156	10.027	13.928	4.645	5.367	27.105	33.309
Itali	13.822	18.225	75.281	115.694	16.146	18.174	91.415	104.079
Spanjë	2.164	3.339	11.776	5.700	1.097	1.364	5.075	6.929
Kroaci	306	804	1.483	4.356	777	886	3.589	4.022
Të tjera të BE-së	3.630	4.975	18.330	25.238	8.043	10.641	40.376	56.174
Mbretëri e Bashkuar	72	409	309	1.133	568	606	2.829	3.687
Kinë	534	933	3.815	6.971	5.751	6.092	31.071	33.495
Kosovë	3.595	3.536	17.251	19.345	1.334	1.615	5.133	7.568
Maqedonia e Veriut	1.467	1.449	5.753	8.986	1.068	1.080	5.369	7.704
Rusi	-	8	8	12	1.089	926	7.042	5.686
SHBA	223	625	2.125	5.296	689	1.051	6.148	5.962
Turqi	473	553	3.028	3.444	8.910	8.574	39.143	55.044
Ukrainë	17	31	164	273	373	249	1.843	2.042
Zvicër	282	299	1.342	2.266	689	516	4.645	3.763
Të tjera	3.865	3.618	15.293	19.836	10.404	18.941	54.632	85.600
Gjithsej	34.856	46.069	176.630	253.062	67.175	81.160	354.209	446.035

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Qershor 2022

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Qershor 2021	Qershor 2022	Jan. - Qershor 2021	Jan. - Qershor 2022	Qershor 2021	Qershor 2022	Jan. - Qershor 2021	Jan. - Qershor 2022
Gjithsej	34.856	46.069	176.630	253.062	67.175	81.160	354.209	446.035
Ushqime, pije, duhan	4.505	5.029	21.395	25.348	11.079	13.278	57.784	71.545
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	7.529	8.723	35.013	56.618	6.256	13.487	31.401	69.399
Produkte kimike dhe plastike	891	3.284	4.721	10.276	9.312	10.200	54.485	56.988
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	162	260	1.015	1.531	1.379	1.436	7.279	9.024
Prodhime druri dhe letre	826	1.158	4.388	6.795	2.594	3.224	12.739	17.181
Tekstile dhe këpucë	10.554	12.016	56.219	68.407	8.074	8.904	42.766	50.133
Materiale ndërtimi dhe metale	6.945	10.788	34.851	59.046	10.185	10.956	51.288	68.222
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	2.609	3.715	14.037	19.025	15.378	16.403	80.842	87.011
Të tjera	835	1.096	4.991	6.018	2.917	3.272	15.624	16.532

Tab.4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Qershor 2022

	Itali		Kosovë		Gjermani		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	75.281	115.694	17.251	19.345	9.510	18.498	10.027	13.928
Ushqim, pije duhan	5.151	5.558	2.133	2.839	609	784	1.816	1.902
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	864	15.678	4.225	3.021	2.869	11.033	3.289	1.616
Produkte kimike dhe plastike	1.244	2.395	1.492	2.165	38	28	385	2.673
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	874	1.421	9	8	34	2	9	21
Prodhime druri dhe letre	2.794	4.148	380	664	118	190	606	1.028
Tekstile dhe këpucë	44.419	53.595	92	97	3.748	4.305	2.586	2.944
Materiale ndërtimi dhe metale	10.487	19.814	7.489	8.842	741	745	1.035	3.243
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	7.034	10.125	699	1.004	1.147	1.194	44	80
Të tjera	2.414	2.960	732	706	206	217	257	421

Tab.5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Qershor 2022

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2021	2022	2021	2022	2021	2022	2021	2022
Gjithsej	91.415	104.079	39.143	55.044	31.071	33.495	27.105	33.309
Ushqim, pije duhan	11.123	13.695	3.405	3.401	463	710	7.926	9.152
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	5.052	2.812	2.651	3.932	8	3	3.574	5.556
Produkte kimike dhe plastike	11.593	12.915	5.327	5.940	4.460	3.364	4.382	5.112
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	6.066	7.269	172	264	326	433	17	13
Prodhime druri dhe letre	2.988	3.735	1.562	2.958	344	506	1.811	2.261
Tekstile dhe këpucë	20.329	25.472	8.646	9.329	5.501	5.277	1.660	2.220
Materiale ndërtimi dhe metale	12.150	13.785	9.632	20.428	2.498	3.758	5.086	5.923
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	18.920	20.470	5.268	6.242	14.469	16.118	1.660	2.264
Të tjera	3.194	3.925	2.481	2.551	3.001	3.327	989	809

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri